



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Raporti i përmbushjes së obligimeve të
komunave nga Agjenda Evropiane për periudhën
Janar – Qershor 2023



Prishtinë, 2023

Përmbajtja

Shkurtesat	3
Hyrje.....	4
Përmbledhje Ekzekutive.....	5
1. KRITERET POLITIKE	7
1.1 Administrata Publike.....	7
1.2 Avokati i popullit	Error! Bookmark not defined.
1.3 Shoqëria civile	8
1.4 Lufta kundër korrupsionit dhe kundër terrorizmit	9
1.5 Mbrojtja dhe trashëgimia kulturore	10
2. KRITERET EKONOMIKE	11
2.1 Ekzistenca e ekonomisë funksionale e tregut.....	11
2.2 Tatimet.....	12
2.3 Ndërmarrjet dhe politikat e industrisë	12
3. STANDARDET EVROPIANE.....	13
3.1 Bujqësia dhe zhvillimi rurale	13
3.2 Energjia	14
3.3 Gjyqësori dhe të drejtat themelore	14
3.4 Mbrojtja e minoriteteve.....	18
3.5 Drejtësia, liria dhe siguria,	19
3.6 Menaxhimi i kufirit dhe migracioni	19
3.7 Arsimi dhe kultura.....	20
3.8 Mjedisi.....	21
3.9 Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit publik.....	22
REKOMANDIMET.....	23

Shkurtesat

BE	Bashkimi Evropian
EVS	Ekipet Vepruese për Siguri
KE	Komisioni Evropian
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
KLSP	Këshillat Lokale për Siguri Publike
MPL	Ministria e Pushtetit Lokal
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OJQ	Organizata joqeveritare
PKZMSA	Programi Kombëtar i Zbatimit të MSA-së

Hyrje

Ky raport paraqet implementimin e obligimeve të komunave, që burojnë nga Agjenda Evropiane gjatë periudhës Janar-Qershor 2023. Duke pasur parasysh se Programi Kombëtar i Zbatimit të MSA është dokument ligjërish i detyrueshëm për të gjitha Institucionet e Kosovës, Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal është e përkushtuar në përbushjen e obligimeve të komunave që dalin nga Agjenda Evropiane.

Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve, MAPL ka zhvilluar disa mënyra të adresimit të çështjeve në nivel lokal për të shtyrë para agjendën evropiane, duke veçuar: koordinimin e procesit të planifikimit, hartimin e planit të përgjithshme për obligimet e komunave në procesin e integritit evropian, hartimin e planeve individuale të komunave si dhe hartimin e raportit të përbushjes së obligimeve të komunave që dalin nga Agjenda Evropiane për dy periudha brenda vitit Janar-Qershor dhe Korrik -Dhjetor.

Raporti ka rol të rëndësishëm dhe domethënës mbi zhvillimin e aktiviteteve të nivelit lokal në fushën e Integritit Evropian, marrë parasysh përgjegjësinë që kanë komunat në raport me qytetarët dhe institucionet publike. Qëllimi i këtij raporti është prezantimi dhe ofrimi i të dhënave të komunave për qytetarët, institucionet vendore dhe ndërkombëtare, organizatat joqeveritare si dhe çdo grupi tjetër të interesit, bazuar në kriteret e përcaktuara nga Bashkimi Evropian.

Përmbledhje Ekzekutive

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2023 kanë raportuar 30 komuna të Republikës së Kosovës ndërsa 8 komuna (Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zveqan, Zubin Potok, Junik, Deçan, Gjakovë, Mamushë) gjatë kësaj periudhe nuk kanë raportuar. Raporti është i bazuar në 55 veprime/masa dhe 177 pyetje/indikator që bien në përgjegjësi dhe kompetencë të komunave, për të cilat Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal ka kërkuar veprime konkrete nga komunat. MAPL në komuna ka adresuar të gjitha çështjet që burojnë nga PKZMSA, nga konkluzionet e nën komiteteve sektoriale si dhe nga sfidat e raportit të KE-së për Kosovën. Sa i përket strukturës së gjithmbarshme, raporti përqendrohet në fushat kryesore të aktiviteteve të cilat kanë të bëjnë me kriteret politike, kriteret ekonomike, standardet evropiane si dhe raporti pasqyron gjendjen reale të arriturave të komunave, por njëkohësisht edhe të sfidave për vitet në vijim.

Në kuadër të **kritereve politike** prezantohet arritja e nivelit lokal në fushat:

- Administrata publike,
- Avokati i popullit,
- Shoqëria civile,
- Lufta kundër terrorizmit,
- Mbrojtja dhe trashëgimia kulturore.

Bazuar në të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë periudhës Janar - Qershor 2023 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përbushin përafërsisht 47% të aktiviteteve të planifikuara në fushën e kritereve politike.

Në kuadër të **kritereve ekonomike** prezantohet arritja e nivelit lokal në fushat:

- Ekzistenca e ekonomisë funksionale e tregut,
- Tatimet,
- Ndërmarrjet, politikat e industrisë dhe tregu i brendshëm.


Bazuar në të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë periudhës Janar - Qershor 2023 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përbushin përafërsisht 35 % të aktiviteteve të planifikuara në fushën e kritereve ekonomike.

Në kuadër të **standardeve evropiane**, prezantohet arritja e nivelit lokal në fushat:

- Bujqësi dhe zhvillimi rural,
- Energji,
- Gjyqësori dhe të drejtat themelore, mbrojtja e minoriteteve,
- Drejtësi,
- Liria dhe siguria,
- Menaxhimi i kufirit dhe migracioni,
- Arsimi dhe Kultura,
- Mjedisi dhe mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit publik.

Bazuar në të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë periudhës Janar-Qershor 2023 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përbushin përafërsisht 70 % të aktiviteteve të planifikuara në fushën e standardeve evropiane.

Në total komunat kanë arritur t'i përbushin përafërsisht 50 % të obligimeve që burojnë nga Agjenda Evropiane, e që bien nën përgjegjësinë e implementimit të qeverisjes lokale.



Grafikoni 1: Përbushja e obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane


1. KRITERET POLITIKE

1.1 Administrata Publike

Një nga fushat kryesore që bënë pjesë në kuadër të kriterëve politike është funksionimi i administratës publike lokale. Në kuadër të kësaj fushe, komunat e Republikës së Kosovës kanë ndërmarr aktivitete lidhur me sigurimin e kapaciteteve të nevojshme për administratën lokale, rritjen e cilësisë së shërbimeve publike për qytetarë, rritjen e efikasitetit dhe transparencës, si dhe ndërtimin e mekanizmave më efikas të llogaridhënies në raport me qytetarët.

Në kuadër të masave për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, Në 25 Komuna (Kamenicë, Viti, Mitrovicë, Istog, Partesh, Prishtinë, Prizren, Klinë, Pejë, Dragash, Glogoc, Hani Elezit, Graçanicë, Kaçanik, Rahovec, Skenderaj, Ferizaj, Suharekë, Gjilan, Fushë Kosovë, Vushtrri, Shtime, Malishevë, Lipjan, Novobërdë) është hartuar programi i trajnimeve për vitin 2023, ndërsa në 5 Komuna (Kllokot, Podujevë, Shtërpçë, Ranillug, Obiliq) nuk është hartuar programi i trajnimeve për periudhën raportuese.

Me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të kornizës së politikave në fushën e administratës, në pasqyrën e të dhënave të komunave mund të shohim se nga 30 komuna raportuese janë 16 Komuna (Istog, Prizren, Klinë, Pejë, Hani Elezit, Graçanicë, Kaçanik, Rahovec, Skenderaj, Ferizaj, Suharekë, Vushtrri, Shtime, Obiliq, Malishevë, Lipjan) është hartuar Strategjia për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, ndërsa në 14 Komuna (Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Podujevë, Kllokot, Partesh, Prishtinë, Dragash, Glogoc, Shtërpçë, Ranillug, Gjilan, Fushë Kosovë, Novobërdë) ende nuk e kanë hartuar.



Grafikoni 2: Programit i trajnimeve dhe Strategjia për Komunikim me Publikun

Po ashtu planin vjetor të komunikimit deri më tani 19 Komuna (Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Podujevë, Prizren, Klinë, Pejë, Gllogoc, Han i Elezit, Kaçanik, Rahovec, Skenderaj, Ferizaj, Suharekë, Gjiilan, Vushtrri, Obiliq, Malishevë, Lipjan) e kanë hartuar, ndërsa në 11 Komuna (Istog, Klllokot, Partesh, Prishtinë, Dragash, Graçanicë, Shtërpçë, Ranillug, Fushë Kosova, Novobërdë, Shtime) ende nuk kanë hartuar.

Sa i përket zbatimit të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik, janë 29 komuna (Kamenicë, Viti, Mitrovicë, Istog, Podujevë, Klllokot, Partesh, Prishtinë, Prizren, Klinë, Pejë, Dragash, Gllogoc, Han i Elezit, Graçanicë, Kaçanik, Rahovec, Skenderaj, Shtërpçë, Suharekë, Ranillug, Gjiilan, Fushë Kosovë, Vushtrri, Shtime, Obiliq, Malishevë, Novobërdë, Lipjan) të cilat kanë raportuar që është duke u zbatuar ky udhëzim, në 1 komuna (*Ferizaj*) është duke u zbatuar pjesërisht. Mirëpo nëse shohim të dhënat e paraqitura në vijim mund të vërejmë që akoma nuk zbatohen dispozitat e U.A në nivel të duhur pasi që rezultatet e konsultimit publik me raportin e të gjitha propozimeve të ofruara nga qytetarët me sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo grupeve tjera të interesit publikohen në një numër të konsiderueshëm të Komunave.

Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit përcakton se në çdo komunë, përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik është njësi/zyrtari për komunikim publik, në përputhje me këtë deri më tani janë 25 Komuna (Kamenicë, Viti, Mitrovicë, Istog, Podujevë, Partesh, Prishtinë, Prizren, Klinë, Pejë, Dragash, Han i Elezit, Graçanicë, Kaçanik, Rahovec, Skenderaj, Shtërpçë, Ferizaj, Suharekë, Gjiilan, Vushtrri, Shtime, Obiliq, Malishevë, Lipjan), të cilat kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik në komunë, ndërsa në 5 Komunë (Klllokot, Gllogoc, Ranillug, Fushë Kosovë, Novobërdë) ende nuk është caktuar zyrtarin përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik.

1.2 Shoqëria civile

Nga të dhënat e ofruara gjatë raportimit shohim se komunat në vazhdimësi kanë përkrahur shoqërinë civile duke i ofruar mbështetje dhe bashkëpunim. Nga të dhënat e pranuar një numër i konsiderueshëm i komunave kanë ofruar mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve. Në 25 Komuna (Kamenicë, Viti, Mitrovicë, Istog, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Klinë, Pejë, Dragash, Gllogoc, Han i Elezit, Graçanicë, Kaçanik, Rahovec, Skenderaj, Ferizaj, Suharekë, Ranillug, Gjiilan, Fushë Kosovë, Vushtrri, Shtime, Obiliq, Malishevë, Novobërdë, Lipjan) buxheti i ndarë për mbështetjen e projekteve të OSHC-ve konform Rregullores 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve është 1,150,659,311 eu, ndërsa në 5 Komuna (Klllokot, Partesh, Shtërpçë, Ferizaj, Ranillug) nuk ka ndarë buxhet. Me këtë mbështetje financiare janë përkrahur OJQ me 583 projekte.

Për nxitjen dhe stimulimin e aplikimit të OJQ-ve në projekte komunale komunat kanë ndërmarr edhe veprime si: *informimi në radio lokale, rrjete sociale dhe thirrje në ueb faqe të komunave, organizime të takimeve informuese për procedurat e aplikimit, ofrimi i ndihmës në plotësimin e dokumentacionit aplikues për gupet e OJQ-ve të cilat janë të marginalizuara, trajtim i barabartë dhe mos diskriminim i aplikuesve etj.* Komunat gjithashtu kanë përkrahur edhe projekte të OJQ-ve për mbrojtjen e komuniteteve pakicë. Në 14 Komuna (*Istog, Prishtinë, Prizren, Mitrovicë Jugore, Pejë, Dragash, Graçanicë, Ferizaj, Gjiilan, Fushë Kosovë, Shtime, Obiliq, Malishevë, Lipjan*) janë përkrahur 61 projekte të OJQ-ve për mbrojtjen e komuniteteve pakicë në vlerë prej 134, 240 mij euro.

1.3 Lufta kundër korrupsionit dhe kundër terrorizmit


Një ndër objektivat më specifike e cila buron nga Strategjia për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm është edhe ngritja e kapaciteteve të institucioneve me qëllim të identifikimit të hershëm të faktorëve dhe proceseve të radikalizmit, andaj më këtë qëllim në 11 komuna (*Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Istog, Podujevë, Prizren, Gllogoc, Han i Elezit, Gjilan, Vushtrri, Obiliq, Malishevë*) në bashkëpunim nivelin qendror dhe donatorë janë organizuar trajnime për zyrtarët komunal të arsimit, mësuesit, dhe menaxhmentin e shkollave për të identifikuar të rinjtë që janë në rrezik për ekstremizëm kurse në 19 komuna (*Viti, Partesh, Kllokot, Prishtinë, Klinë, Pejë, Dragash, Graçanicë, Kaçanik Rahovec, Skenderaj, Shtërpçë, Ferizaj, Suharekë, Ranillug, Novobërdë, Lipjan, Fushë Kosova, Shtime*) nuk janë organizuar.

Për mbështetjen dhe parandalimin e luftës kundër terrorizmit, radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, janë 14 komuna që kanë ndërmarrë veprime konkrete për vetëdijesimin e qytetarëve kundër radikalizmit që mund të shpijë në ekstremizëm të dhunshëm si: *takime të rregullta përmes këshillave lokale dhe imamëve të xhamive lokale, takime me nxënës të shkollave të ndryshme, janë krijuar hapësirat e sigurta në shkolla për nxënësit që të bëjnë pyetje privatisht rreth çështjeve të ndjeshme sociale, fushata vetëdijesuese me qytetarët, aktivitete në terren, diskutime gjatë takimeve të rregullta me anëtarët e KKSB-së, takime me rinin, gra dhe strukturat arsimore me qëllim të identifikimit të faktorëve që ndikojnë në rritjen e ekstremizmit me radikalizëm etj* ndërsa 16 komuna (*Kllokot, Prishtinë, Klinë, Pejë, Gllogoc, Graçanicë, Kaçanik, Rahovec, Skenderaj, Shtërpçë, Ranillug, Obiliq, Lipjan, Fushë Kosova, Vushtrri, Shtime*) nuk janë ndërmarrë veprime. Në 30 komuna nuk ka pasur asnjë rast të paraqitur në Këshillat Komunal të Sigurisë në Bashkësi lidhur me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin.

Më qëllim të luftimit të korrupsionit, komunat në vazhdimësi në rast të konfliktit të interesit nga zyrtarët komunal kanë deklaruar rastet e konfliktit të interesit. Gjatë periudhës Janar-Qershor 2023, në 29 komuna nuk ka pasur asnjë rast të konfliktit të interesit nga zyrtarët komunal. Në 1 Komunë (Malishevë) është 1 rast i raportuar i konfliktit të interesit nga zyrtarët.

Sa i përket anëtarëve të kuvendit, që kanë deklaruar konfliktin e interesit para marrjes së vendimeve në kuvend të komunës në 2 komuna (Podujevë, Kaçanik) janë paraqitur 2 raste, ndërsa në 28 Komuna nuk ka pasur raste të tilla.

Plani Lokal për Integritet është hartuar në 22 komuna ndërsa në 8 komuna (*Kllokot, Partesh, Prishtinë Klinë, Graçanicë, Shtërpçë, Gjilan, Novobërdë*) nuk është hartuar Plani Lokal për Integritet. Pjesa më e madhe e komunave sipas raportimeve e kanë të caktuar zyrtarin që raporton për Planin Lokal të Integritetit nga 30 komuna raportuese 18 komuna kanë caktuar zyrtarin përkatës, ndërsa 12 komuna (*Kamenicë, Istog, Kllokot, Prishtinë, Partesh, Graçanicë, Shtërpçë, Ferizaj, Ranillug, Gjilan, Novobërdë, Fushë Kosovë*) nuk e kanë caktuar ende zyrtarin.



Grafikoni 3: Plani Lokal për Integritet dhe zyrтарi i caktuar për planin e integritetit

Sa i përket implementimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, për krijimin e qasjes për shërbimin në gjuhët zyrtare janë 25 komuna të cilat kanë ndërmarr veprimet si: *organizim i trajnimeve, kurse për gjuhën serbe dhe shqipe, janë punësuar zyrtarë për përkthim, ofrohen shërbime simulante nëpër të gjitha takimet zyrtare, materialet e organeve komunale përkthehen të gjitha në gjuhë zyrtare, shpërndahen broshura të ndryshme për promovimin e të drejtave gjuhësore për të gjitha komunitete etj* ndërsa Në 5 komuna (Podujevë Kllokot, Pejë, Hani Elezit, Shtime) nuk kanë ndërmarr veprime. Ashtu siç parashihet në Ligjin për përdorimin e gjuhëve si dhe në rregulloret komunale për gjuhët zyrtare, në 25 komuna bëhet publikimi i akteve komunale në gjuhët zyrtare, ndërsa në 3 Komuna (Viti, Ferizaj, Malishevë) Publikohen pjesërisht, dhe në 2 Komuna (Kllokot, Hani Elezit,) nuk publikohen.

1.4 Mbrojtja dhe trashëgimia kulturore

Në fushën e trashëgimisë kulturore sfidë e komunave vazhdon ende të mbetet hartimi i planeve komunale për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, pasi që sipas të dhënave nga 30 komuna raportuese të komunave janë vetëm 4 komuna (Prizren, Vushtrri, Rahovec, Skenderaj) të cilat kanë hartuar këtë plan.

Sfidat që 26 komuna (Kamenicë, Viti, Mitrovicë, Istog, Podujevë, Kllokot, Partesh, Prishtinë, Ferizaj, Suharekë, Ranillug, Gjilan, Fushë Kosovë, Shtime, Obiliq, Malishevë, Novobërdë, Lipjan, Klinë, Dragash, Glllogoc, Hani Elezit, Graçanicë, Kaçanik, Shtërpçë, Pejë,) komunat ende nuk e kanë hartuar Planin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore kryesisht kanë qenë: *Mungesa e stafit profesional, mungesa e ekspertëve, mungesa e mjeteve buxhetore, sfidat lidhur me regjistrimin dhe dokumentimin e trashëgimisë kulturore ekzistuese etj.*

Gjatë kësaj periudhe numri i shkeljeve dhe ndërtimeve ilegale në zonat e mbrojtura në 3 Komuna (Kamenicë, Istog, Prizren) është 6 shkelje.

Po ashtu, 11 komuna (Prizren, Podujevë, Klinë, Pejë, Dragash, Rahovec, Suharekë, Gjilan, Fushë Kosovë, Obiliq, Lipjan) janë siguruar pajisjet për monitorimin e sigurisë/instalimi i kamerave te objekteve të trashëgimisë kulturore, në 2 Komuna (Istog, Viti) pjesërisht, dhe në 17 Komuna (Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Prishtinë, Partesh, Kllokot, Glllogoc, Hani Elezit, Graçanicë, Kaçanik, Skenderaj, Shtërpçë, Ferizaj, Ranillug, Vushtrri,

Shtime, Malishevë, Novobërdë) nuk janë siguruar pajisjet për monitorimin e sigurisë/instalimi i kamerave te objekteve të trashëgimisë kulturore.

Në 3 komuna (Klinë, Pejë, Fushë Kosovë) janë nënshkruar Memorandume të bashkëpunimit për detyrat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e Kishave Ortodokse. Në 27 Komuna (Kamenicë, Viti, Mitrovicë, Istog, Podujevë, Klllokot, Partesh, Prishtinë, Prizren, Hani Elezit, Graçanicë, Rahovec, Skenderaj, Shtërpçë, Ferizaj, Suharekë, Ranillug, Gjilan, Vushtrri, Shtime, Obiliq, Lipjan, Malishevë, Novobërdë, Dragash, Glllogoc, Kaçanik) nuk janë nënshkruar sepse disa prej tyre nuk kanë kisha.

Për funksionimin e Këshillit të fshtatit për Hoçën e Madhe, komuna e Rahovecit i ka përfunduar me kohë të gjitha procedurat për themelimin e këtij këshilli. Ky këshill është funksional.

Për zbatimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, për periudhën Janar-Qershor 2023 komuna e Prizrenit nuk ka alookuar buxhet, nuk ka pasur asnjë ndërtim ilegal brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura në Komunën e Prizrenit. Është filluar procesi i legalizimeve të objekteve të ndërtuara pa leje si dhe janë caktuar inspektorët komunal për të inspektuar ndërtimet pa leje në Zonën e Mbrojtur të qytetit.

Në Komunën e Fushë Kosovës është bërë studimi i fizibilitetit për themelimin e Muzeut të Natyrës i cili është duke u ndërtuar në bashkëpunim me Ministrin e Kulturës, Rinis dhe Sportit.

Gjithashtu me qëllim të për ndërgjegjësimin dhe promovimin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore komunat kanë ndërmarrë aktivitetet të ndryshme. Në 21 Komuna (Kamenicë, Viti, Istog, Podujevë, Klllokot, Partesh, Prishtinë, Prizren, Klinë, Pejë, Dragash, Glllogoc, Hani Elezit, Graçanicë, Kaçanik, Rahovec, Shtërpçë, Ferizaj, Gjilan, Fushë Kosovë, Malishevë) janë realizuar këto aktivitete: *promovimi I aseteve të trashëgimisë në media televizive, tryeza dedikuar trashëgimisë, hartimin e hartave zonale dhe broshurave për promovim të turizmit në komunë Organizimi i ekspozitës "Trashëgimia Kulturore Nëpërmjet Objekteve Etnografike, Vizita Muzeut të Qytetit, Konservimin dhe Restaurimin e Sabat Kullës, Iniciativa për themelimin e muzeut të qytetit, bashkëpunim me ekspert të lëmisë së trashëgimisë kulturore, formimi i grupit punues në evidentimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, hartimi i hartave zonale dhe broshurave për promovim të turizmit, vizita të ndryshme në objektet që janë nën mbrojtje etj, ndërsa në 9 Komuna (Mitrovicë Jugore, Skenderaj, Suharekë, Ranillug, Shtime, Novobërdë, Lipjan, Vushtrri, Obiliq) nuk janë mbajtur aktivitete.*


2. KRITERET EKONOMIKE

2.1 Ekzistenca e ekonomisë funksionale e tregut

Për ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët është paraparë krijimi i qendrave për regjistrimin e bizneseve (one stop shop-et) të cilat lehtësojnë ofrimin e shërbimeve për biznese përfshirë regjistrimet e tyre. Në 26 komuna janë funksionale, ndërsa në 4 Komuna (Klllokot, Partesh, Prishtinë, Ranillug) nuk janë themeluar.

Numri i inspektorëve të tregut në 27 komuna është 51, ndërsa janë 2 Komuna (Shtërpçë, Ranillug) nuk ka inspektor, dhe 1 Komunë (Prishtinë) nuk ka ofruar të dhëna. Gjithashtu numri i inspektimeve në 25 komuna është 3,574 inspektime, ndërsa 5 Komuna (Prishtinë, Klllokot, Shtërpçë, Shtime, Novobërdë) nuk ka pasur asnjë inspektim.

Sa i përket dëgjimeve publike për planifikimin e buxhetit në 24 komuna janë mbajtur 95 dëgjime publike , kurse në 6 komuna (Graçanicë, Skenderaj, Shtërpçë, Fushë Kosova, Vushtrri, Novobërdë) nuk janë mbajtur.



Grafikoni 4: Numri i dëgjimeve publike për planifikim të buxhetit

2.2 Tatimet

Me qëllim të luftimit të ekonomisë jo formale në 23 komuna janë ndërmarr veprime si: *kontrollet e vazhdueshme tek bizneset lidhur me lëshimin e kuponëve fiskal, Mbyllja e subjekteve ilegale deri në kompletimin e dokumentacionit adekuat për ushtrimin e veprimtarisë, Obligimi i bizneseve për tu regjistruar pranë ARBK, produkteve të cilat kanë qenë pa deklaracion në gjubën zyrtare janë larguar nga shitja kurse produktet që kanë qenë pa origjinë janë sekuestruar dhe asgjësuar në prani të personave që kanë bërë tregtimin e tyre në mënyrë të pa ligjshme, vërejtje, inspektime mbi posedimin certifikatave të regjistrimit të bizneseve, inspektim dhe kontrolle të vazhdueshme të lokaleve afariste, mbyllja e subjekteve ilegale, ofrimi i këshillave të nevojshme për të operuar ligjshëm etj*, ndërsa 7 komuna (*Shtërpcë, Prishtinë, Kllokot, Gjiçan, Fushë Kosovë, Ranillug, Shtime*) nuk është ndërmarr asnjë veprim.

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2023, nga 30 komuna raportuese 23 prej tyre kanë pranuar 238 rekomandime nga Auditori i Përgjithshëm. Prej tyre të adresuar janë 145 rekomandime, të pa adresuara mbesin 62 rekomandime dhe pjesa tjetër gjenden në proces.

Njësia e Auditimit të Brendshëm është e funksionalizuar në 24 komuna, ndërsa 6 komuna (Istog, Kllokot, Partesh, Hani Elezit, Shtime, Ranillug) nuk funksionon. Sa i përket planifikimit të pronës komunale për zhvillim ekonomik lokal, janë 25 komuna të cilat kanë publikuar regjistrin e pronës komunale, ndërsa në 5 komuna (Kllokot, Partesh, Shtërpcë, Obiliq, Novobërdë) nuk është publikuar.

Në 20 Komuna (Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Podujevë, Prizren, Klinë, Pejë, Dragash, Glllogoc, Kaçanik, Rahovec, Skenderaj, Shtërpcë, Ferizaj, Gjiçan, Fushë Kosovë, Vushtrri, Obiliq, Malishevë, Lipjan) është themeluar komiteti për auditim, ndërsa në 10 Komuna (Istog, Kllokot, Partesh, Prishtinë, Hani Elezit, Graçanicë, Suharekë, Novobërdë, Shtime, Ranillug) nuk është themeluar.

2.3 Ndërmarrjet dhe politikat e industrisë

Në 9 komuna është bërë funksionalizimi i zonave ekonomike, ndërsa në 17 Komuna (Viti, Klllokot, Partesh, Prishtinë, Prizren, Pejë, Hani Elezit, Kaçanik, Rahovec, Skenderaj, Ferizaj, Ranillug, Gjilan, Fushë Kosovë, Vushtrri, Malishevë, Novobërdë) nuk është bërë. Në 3 komuna (Mitrovicë Jugore, Podujevë, Klinë) pjesërisht. Ndërsa 1 komunë (Kamenicë) ka raportuar se nuk ka zona ekonomike.

3. STANDARDET EVROPIANE

3.1 Bujqësia dhe zhvillimi rurale

Në sektorin e bujqësisë sfidë e theksuar mbetet hartimi i dokumenteve për rregullimin e mëtejshëm të tokave bujqësore pasi që nga 30 Komuna raportuese vetëm në 11 komuna (Kamenicë, Podujevë, Prizren, Ferizaj, Shtime, Lipjan Dragash, Glllogoc, Hani Elezit, Graçanicë, Rahovec) është hartuar Plan Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, ndërsa në 19 komuna (Suharekë, Ranillug, Gjilan, Fushë Kosovë, Vushtrri, Obiliq, Novobërdë, Klinë, Pejë, Kaçanik, Skenderaj, Shtërpçë, Viti, Mitrovicë Jugore, Istog, Klllokot, Partesh, Prishtinë, Lipjan) ende nuk është hartuar Plan Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Gjatë periudhës Janar-Qershor 2023 në 18 komuna (Podujevë, Klllokot, Prishtinë, Prizren, Frizaj, Ranillug, Gjilan, Fushë Kosovë, Shtime, Novobërdë Pejë, Dragash, Glllogoc, Hani Elezit, Graçanicë, Kaçanik, Skenderaj, Shtërpçë) numri i kërkesave të parashtruara për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore është 186, ndërsa 12 komuna (Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Istog, Partesh, Suharekë, Vushtrri, Obiliq, Malishevë, Lipjan Klinë, Rahovec) nuk ka pasur kërkesa të parashtruara.. Krahas kësaj lidhur me këto kërkesa janë nxjerr 163 vendime nga 18 komuna (Podujevë, Klllokot, Prishtinë, Prizren, Viti, Ferizaj, Gjilan, Fushë Kosovë, Shtime, Lipjan Pejë, Dragash, Glllogoc, Hani Elezit, Graçanicë, Kaçanik, Skenderaj, Shtërpçë), ndërsa në 12 komuna (Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Istog, Partesh Suharekë, Ranillug, Vushtrri, Obiliq, Malishevë, Novobërdë Klinë, Rahovec) nuk ka pasur asnjë vendim të miratuar.

Lidhur me konsolidimin e mëtejshëm të qendrave informative këshilluese komunale për bujqësi dhe zhvillim rural në 22 komuna (Kamneicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Istog, Partesh, Prishtinë Ferizaj, Suhareka, Gjilan, Fushë Kosovë, Obiliq, Malishevë, Novobërdë, Lipjan Klinë, Pejë, Dragash, Glllogoc, Graçanicë, Kaçanik, Rahovec, Skenderaj) janë funksionalizuar këto qendra. Në 8 komuna (Ranillug, Vushtrri, Shtime Podujevë, Klllokot, Prizren, Hani Elezit, Shtërpçë) nuk janë funksionalizuar.

Për mbrojtjen e tokave bujqësore dhe promovimin e rëndësisë së tokave bujqësore, në 21 komuna (Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Partesh, Prishtinë, Prizren Ferizaj, Suharekë, Ranillug, Gjilan, Fushë Kosovë, Shtime, Obiliq, Malishevë, Novobërdë, Lipjan Klinë, Pejë, Glllogoc, Kaçanik, Skenderaj) është ofruar mbështetje për 2985 fermer në sektorin e bletarise, blegtorisë, perimtarisë, shpezetaris, hortikulturës, ndërsa 9 komuna (Istog, Podujevë, Klllokot Dragash, Hani Elezit, Graçanicë, Rahovec, Shtërpçë, Vushtrri) nuk janë mbështetur.

Sa i për ketë inspektorëve të bujqësisë, në 6 komuna (Klllokot, Shtime, Klinë, Glllogoc, Graçanicë, Rahovec) ka inspektor të bujqësisë, ndërsa në 24 komuna (Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Partesh, Istog, Podujevë, Prishtinë, Prizren Ferizaj, Suharekë, Ranillug, Gjilan, Fushë Kosovë, Vushtrri, Obiliq, Malishevë, Novobërdë, Lipjan Pejë, Dragash, Hani Elezit, Kaçanik, Skenderaj, Shtërpçë) nuk ka asnjë inspektor të bujqësisë. Në shumicën e komunave ku nuk ka inspektor të bujqësisë në këto raste inspektimet realizohen nga inspektori sanitar, inspektori regional, inspektori i veterinarisë, inspektori komunal, inspektori i ndërtimit, inspektorët nga Zyra Rajonale e AUVK-ut, nga niveli qendror, koordinatori i bujqësisë. Numri i inspektimeve bujqësore në 8 komuna (Partesh, Shtime, Obiliq, Novobërdë, Lipjan Klinë, Glllogoc, Skenderaj) është 1,251 inspektime.

Në 14 komuna (Ferizaj, Suharekë, Gjilan, Malishevë, Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Istog, Podujevë, Kllokot, Prishtinë, Prizren Dragash, Shtërpçë) nuk ka pasur asnjë inspektim, ndërsa në 8 komuna (Ranillug, Fushë Kosovë, Vushtrri, Pejë, Hani Elezit, Graçanicë, Kaçanik, Rahovec) nuk kanë ofruar informacione.

Në 6 komuna (Istog, Podujevë, Fushë Kosovë, Pejë, Rahovec, Shtërpçë) ka pasur raste të humbje të tokës bujqësore, ndërsa në 19 komuna (Klinë, Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Kllokot, Partesh, Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Suharekë, Gjilan, Shtime, Obiliq, Malishevë, Novobërdë, Lipjan Dragash, Glllogoc, Hani Elezit) nuk ka humbje të tokës bujqësore, ndërsa në 5 komuna (Graçanicë, Ranillug, Vushtrri, Kaçanik, Skenderaj) nuk kanë ofruar informacione.

Në komunat (Pejë, Istog, Podujevë, Fushë Kosovë, Shtime, Rahovec, Shtërpçë) në të cilat ka pasur raste të humbjes së tokës bujqësore është ndërtuar shtrati i lumit, janë kryer insptime , është bërë ndërprerja e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësor në tokë ndërtimore dhe ka pasur gjoba. Në 14 komuna (Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Kllokot, Partesh, Prishtinë, Prizren Ferizaj, Suharekë, Malishevë, Novobërdë, Lipjan Dragash, Klinë) nuk ka pasur humbje të tokës bujqësore, ndërsa në 9 komuna (Glllogoc, Ranillug, Gjilan, Vushtrri, Obiliq Hani Elezit, Graçanice, Kaçanik, Skenderaj) nuk kanë ofruar informacione.

Planin për Menaxhimin e tokave rurale e posedojnë 15 komuna (Podujevë, Ferizaj, Suharekë, Ranillug, Gjilan, Fushë Kosovë, Vushtrri, Obiliq, Malishevë, Novobërdë, Lipjan Dragash, Hani Elezit, Graçanicë, Kaçanik). Në 11 komuna (Viti, Mitrovicë Jugore, Istog, Kllokot, Partesh, Prishtinë Klinë, Pejë, Glllogoc, Rahovec, Shtërpçë) nuk është hartuar. Në 2 komuna (Shtime, Skenderaj) nuk kanë ofruar informacione, ndërsa në 2 komuna (Kamenicë, Prizren) këtë qështje e kanë të rregulluar në kuadër të PZHK.

3.2 Energjia


Me qëllim të zbatimit të obligimeve të dala nga MSA komunat në vazhdimësi kanë bërë zhvillime të mëtejme në politikat e fushës së efijencës së energjisë. Planin për Efijencë të Energjisë e kanë hartuar 10 komuna (Glllogoc, Ferizaj, Suharekë, Obiliq, Novobërdë, Istog, Partesh, Prishtinë, Prizren Shtërpçë, ndërsa në 20 komuna (Klinë, Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Podujevë, Kllokot Ranillug, Fushë Kosovë, Gjilan, Vushtrri, Malishevë, Lipjan Pejë, Dragash, Hani Elezit, Graçanicë, Kaçanik, Rahovec, Skenderaj, Shtime) ende nuk është hartuar ky Plan.

Me qëllim të zbatimit të këtij plani, në 23 komuna (Klinë, Kamenicë, Viti, Istog, Podujevë, Partesh, Prizren, Mitrovicë Jugore, Prishtinë Ferizaj, Suharekë, Ranillug, Gjilan, Obiliq, Malishevë, Pejë, Dragash, Glllogoc, Hani Elezit, Graçanicë, Kaçanik, Rahovec, Shtërpçë) ka pasur projekte në masat e zbatimit të efijencës. Disa nga projektet janë: Vendosija e poqëve eficient në qytet dhe në fshatra, nënshkrimi i projektit për Shërbime të Energjisë ESKO, Izolimi i objekteve arsimore dhe objekteve të tjera publike me masat për efijencë të energjisë, Ndërrimi i trupave ndriçuese me trupa efijentë – LED, ndërtimi i sistemeve të reja të ngrohjes qendrore nëpër objektet publike etj. Në 7 komuna (Kllokot, Vushtrri, Novobërdë, Lipjan Graçanicë, Fushë Kosova, Shtime) nuk ka pasur asnjë projekt.

Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Në kuadër të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi komunat janë të obliguar të caktojnë njësinë apo zyrtarin përkatës për të koordinuar dhe raportuar zbatimin e këtij ligji dhe sipas të dhënave zyrtare mund të shohim se

deri më tani në 21 komuna (Ferizaj, Suharekë, Gjilan, Fushë Kosovë, Vushtrri, Shtime, Malishevë, Lipjan, Kamenicë, Istog, Podujevë, Partesh, Prizren, Klinë, Dragash, Hani Elezit, Graçanicë, Rahovec, Skenderaj Shtërpce, Mitrovicë Jugore) është emëruar zyrtari përkatës për mbrojtjen e diskriminimit , ndërsa në 9 komuna (Ranillug, Obiliq, Viti, Klllokot, Prishtinë Novobërdë, Pejë, Glllogoc, Kaçanik) nuk është emëruar. Sa i përket zyrtarit përkatës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në 26 komuna (Ferizaj, Suharekë,Ranillugë,Gjilan, Fushë Kosovë,Vushtrri, Shtime, Malishevë, Lipjan, Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Partesh, Istog, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Klllokot Klinë, Pejë, Dragash, Hani Elezit, Graçanicë, Kaçanik, Rahovec, Skenderaj Shtërpce) është emëruar zyrtari , ndersa në 4 komuna (Glllogoc, Obiliq, Novobërdë, Viti) nuk është emëruar zyrtari përkatës. Kurse zyrtari për barazi gjinore është caktuar në 28 komuna (Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Partesh, Istog, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Klllokot, Viti, Ferizaj, Suharekë, Ranillug, Gjilan, Fushë Kosovë, Vushtrri,Shtimë, Obiliq, Malishevë, Lipjan Klinë, Dragash, Glllogoc, Hani Elezit, Graçanicë, Kaçanik, Rahovec, Skenderaj Shtërpce), ndërsa në 2 komuna (Pejë, Novobërdë) nuk është emëruar zyrtari përkatës.



Grafikoni 5: Caktimi i zyrtarëve për zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi

Në 13 komuna (Ranillug, Fushë Kosovë, Vushtrri, Obiliq, Malishevë, Lipjan Mitrovicë Jugore, Istog Klinë, Pejë, Graçanicë, Rahovec, Skenderaj) janë ndarë mjete buxhetore me shumë prej 171,640.00 euro për zhvillimin e aktiviteteve në fushën e të drejtave të njeriut ndërsa në 17 komunat tjera (Suharekë, Novobërdë, Kamenicë, Viti, Podujevë, Klllokot, Partesh, Prishtinë, Prizren Dragash, Glllogoc, Kaçanik, Shtërpçë, Ferizaj, Gjilan, Shtimë, Hani Elezit) nuk është ndarë buxhet.

Një ndër sfidat e evidentuara nga raporti i KE-së për Kosovën për nivelin lokal është kujdesi për të moshuarit mbetet një çështje serioze. Nga të dhënat e ofruara rezulton se në 9 komuna (Istog, Prishtinë Suharekë, Shtime, Novobërdë, Lipjan, Graçanicë, Skenderaj, Prizren) ofrojnë përkujdesje rezidenciale për të moshuarit, ndërsa 21 komuna (Obiliq, Ferizaj, Ranillug, Gjilan, Fushë Kosovë, Vushtrri, Malishevë Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Podujevë, Klllokot, Partesh, Klinë, Pejë, Dragash, Glllogoc, Hani Elezit, Kaçanik, Rahovec, Shtërpce) nuk ofrojnë përkujdesje rezidenciale për të moshuarit.

Sipas legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë secila komunë, përmes drejtoratit të saj përkatës, është përgjegjëse për sigurimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të saj sipas standardit të specifikuar nga Ministria. Gjithashtu në 9 komuna (Suharekë, Shtime, Obiliq, Novobërdë, Lipjan, Istog, Prishtinë Graçanicë, Skenderaj) gjenden 10 qendra për të moshuarit, ndërsa ne 21 komuna (Klinë, Kamenicë, Viti,

Mitrovicë Jugore, Podujevë, Klllokot, Partesh, Prizren, Ferizaj, Ranillug, Gjiilan, Fushë Kosovë, Vushtrri, Pejë, Dragash, Glllogoc, Hani Elezit, Kaçanik, Rahovec, Shtërpçë, Malishevë) nuk kanë qendra për të moshuarit.

